

Prof. dr. Iljaz REXHA

VEPRIMTARIA E DEGËS SË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT NË PRISHTINË

Pas luftës ruso-turke, Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit me vendimet e tyre jo vetëm që i linin tokat shqiptare nën sundimin e Perandorisë Osmane, por parashihnin që shumë territore të tyre t'u dorëzoheshin shteteve ballkanike.

Bullgaria e Madhe e Shën Stefanit parashihej të përfshinte deri në kufijtë perëndimorë të kazave të Korçës dhe të Starovës, duke përfshirë edhe trojet e tjera shqiptare : Kaçanikun, Gostivarin, Dibrenë, Kërçovën, Strugën, Pogradecin dhe Korçën.

Për Malin e Zi parashihej që territori i tij të rritej tri herë e gjysmë, duke përfshirë tokat e banuara kryesisht me shumicën e popullsisë shqiptare, si: Ulqinin, Krajën, Anamalin, Gucinë dhe Rugovën.

Serbia parashihej të merrte disa territore shqiptare në Sanxhakun e Prishtinës deri në afërsi të Mitrovicës, duke përfshirë Prokuplen, Kurshumlinë, Topanicën, Llap-Gollakun, që ishin kryesisht të banuara me popullsi shqiptare.

Këto vendime e cenuan shumë rëndë identitetin kombëtar dhe integritetin tokësor të shqiptarëve. Ato ndikuan që më tepër të organizohet dhe të intensifikohet Lëvizja Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, e cila kishte filluar qysh nga vitet 1830.

Kjo lëvizje gjatë viteve 1878-1881 u shndërrua në një organizatë politike ushtarake, e cila, gradualisht, e shkatërroi pushtetin osman në viset shqiptare dhe e mori në duar të veta. Në fillim të vitit 1881 arriti shkallën më të lartë të organizimit të saj me formimin e Qeverisë së Përkohshme Shqiptare.

Sipas burimeve osmane dhe disa burimeve sllave me iniciativën dhe angazhimin e gjithanshëm të Komitetit të Stambollit u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në të cilën më vonë u bënë jo vetëm anëtarë, por edhe udhëheqës kryesorë të Komitetit Qendror të Lidhjes së Prizrenit dhe të Degëve të saj në mbarë Shqipërinë. Pohimi i disa autorëve të huaj se Lidhja kishte karakter panislamik dhe proosman nuk mund të dëshmohet meqë në këtë Lidhje përveç prijësve të popullit shqiptar të besimit islam u inkuadruan edhe prijësit shqiptarë të besimit katolik, në Kosovë e Shqipërinë Qendrore, si edhe prijësit shqiptarë të besimit ortodoks. Po të kishte Lidhja karakter panislamik, atëherë Porta e Lartë nuk do të shtypte atë me forca ushtarake.

Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe degët e saj i formuan kryesisht përfaqësuesit dhe deputetët shqiptarë që, në mars të vitit 1877, ishin zgjedhur në Parlamentin Osman në krye me Haxhi Ymer Prizrenin si edhe anëtarët e Komitetit të Stambollit dhe të Shoqatës Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip ku ishin inkuadruar shumë patriotë dhe intelektualë që zhvillonin një veprimtari politike dhe kulturore për të mirën e kombit shqiptar. Pas formimit të Komitetit Qendror të Lidhjes së Prizrenit me qendër në Prizren njëkohësisht filluan të formohen edhe degët në të gjitha qytetet e vilajeteve shqiptare: Prizren, Prishtinë, Ulqin, Shkodër, Shkup, Tetovë, Dibër, Gjirokastrë, Janinë, Artë, Prevezë e në disa vende të tjera.

Dega e Lidhjes Shqiptare në Prishtinë u formua me iniciativën e Abdurrahman Gjinolli, Zija Prishtina, Zejnelabedin Prishtina, Alidanish Prishtina të cilët në Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes së Prizrenit, që u mbajt në Prizren, më 17 qershor të vitit 1878 nuk e nënshkruan Karanamenë (aktvendimet) që i takonin rrymës radikale

autonomiste pra krahut të Ymer Prizrenit dhe Abdyl Frashërit, Ahmet Koronicës dhe Sylejman Vokshit, ndërsa Haxhi Zija Çausi dhe Rauf Aga që ishin anëtarë të Degës së Prishtinës e kishin nënshkruar Karanamen si përkrahës të rrymës konservative prosulltane.

Abdurrahman Gjinolli ishte babai Zija dhe Ali Danish Prishtinës, i cili kishte trashëguar pasuri dhe toka të mëdha nga babai i tij Jashar pashë Gjinolli i cili në vitin 1840 ishte likuiduar së bashku me Mahmut pashë Rrotullin nga Prizreni që kishin marrë pjesë në kryengritjet e viteve 30-40 së bashku me Mustafa pashë Bushatin që në atë kohë tentonin të shkëputeshin nga sundimi osman.

Veprimi i parë i Degës së Lidhjes në Prishtinë u aktivizua rreth mbrojtjes së kufijve me Serbinë sidomos pas pushtimit të Prokuplës, Kurshumlisë, Leskofcit, që ishin të banuara kryesisht me popullsi shqiptare ku u dëbuan 700 vendbanime nga pushtimit të këtyre tokave të banuara me popullsi shqiptare ishin deputetët shqiptarë në Parlamentin osman ishin: Ymer Prizreni përfaqësues i Sanxhakut të Prizrenit, Zejnelabedin Prishtina që ishte më vonë nënkryetar i Degës së Lidhjes për Prishtinën, Mustafa Efendiu nga Kosova, Abdyl Frashëri e disa deputetë të tjerë. Këta deputetë në atë kohë kërkonin nga Porta e Lartë që të gjithë muhaxhirët e dëbuar me dhunë nga Sanxhaku i Nishit të riktheheshin në vatrat e tyre shekullore.

Mirëpo, Porta e Lartë këtë kërkesë e konsideronte si rrezik për një konflikt të ri me Serbinë dhe Rusinë. Dega e Lidhjes në Prishtinë nga udhëzimet e marra nga Ymer Prizreni, Zija Prishtina dhe Zejnelabedin Prishtina, bëri përpjekje maksimale që muhaxhirët e ardhur nga Sanxhaku i Nishit përsëri t'i kthejë në vendbanimet e tyre të mëhershme. Ajo ndërmarrë edhe aksione ushtarake, por pa sukses, me që Porta e Lartë nuk i përkrahte këto aksione ngase frikësohej se përsëri do të fillonte luftë e re me Serbinë.

Sipas një dokumenti osman të datës 3 prill të vitit 1879, shihet se në qendrën e Vilajetit të Kosovës, në Prishtinë nga Dega e Lidhjes dhe paria shqiptare kishte formuar një Komision i veçantë për vendosjen, sistemimin dhe përkujdesjen e muhaxhirëve të dëbuar me

dhunë nga Sanxhaku i Nishit. Kryetari i këtij Komisioni është emëruar Bejtullah Aga, nga paria e Prishtinës, të cilit iu kishte premtuar rroga mujore 1.000 groshë. Në këtë dokument thuhet: "... gati po bëhet një vit që kur është emëruar kryetar i Komisionit të lartpërmendur për vendosjen dhe zgjidhjen e nevojave të tjera të muhaxhirëve".

Problemi i muhaxhirëve, në përgjithësi, ishte i ngutshëm edhe gjatë kohës kur u formua Lidhja e Prizrenit. Kjo shihet edhe nga telegrami i mytesarifit të Bigës, të Vilajetit të Selanikut, i cili më 1 qershor të vitit 1879, lajmëron se 440 familje të muhaxhirëve, me një anije ruse, janë transportuar nga limani i Konjës për në Anadoll.

Më 17 qershor 1880, valiu i Selanikut, lajmëron Qeverinë Osmane se një grup i muhaxhirëve të Kosovës, i cili gjendet ende në Selanik, për arsye të sëmundjeve të tyre, ende nuk janë transportuar për në Anadoll, mirëpo, ata nesër do të nisen me një anije osmane në drejtim të Çana Kalasë. Me këtë rast, do të udhëtojnë gjithsej 208 muhaxhirë, prej tyre 67 meshkuj, 90 femra, 22 fëmijë meshkuj, 20 fëmijë femra, si dhe 10 të veja pa familje.

Për të ilustruar këtë fakt po japim një pjesë të këtij telegrami:

"Valiu i Selanikut, me telegramin nr. 5110 të datës 17 qershor të vitit 1879, e lajmëron Kryeministrinë në Stamboll se muhaxhirët e Kosovës, të cilët kanë qenë të paraparë të transportohen edhe më herët për në Anadoll, për shkak të sëmurjes së tyre ende nuk janë transportuar, mirëpo, kësaj të shtune do të transportohen me anije që lundron në drejtim të Çana Kalasë".

Sipas disa burimeve osmane, del se Lidhja ndërmori masa të nevojshme për mbrojtjen e çështjes dhe të interesit të muhaxhirëve, që kishin ikur nga Sanxhaku i Nishit, që në shumicë ishte i banuar me popullsi shqiptare, kurse më vonë qenë shpërngulur në Anadoll.

Për këtë fakt, gjejmë edhe shënime interesante në një telegram, të datës 19 qershor të vitit 1879, dërguar Qeverisë Osmane, nga Vilajeti i Kosovës.

Mehmet Ali Pasha së pari arriti në Prishtinë dhe u takua me parinë e Prishtinës megjithëse tregoi një dozë skepticizmi, u duk se i

pranoi propozimet e Mehmet Ali Pashës, sikurse thoshte ai se Malit të Zi do t'i dorëzohej vetëm një pjesë e vogël nga viset e banuara me popullsi shqiptare, por në esencë kjo pari ishte me këmbëngulje kundër zbatimit të Vendimeve të Kongresit.

Dega e Lidhjes në Prishtinë, e cila ishte mjaft aktive, po ato ditë, para se të arrinte Mehmet Ali Pasha në Prishtinë, filloi të aktivizohej edhe më tepër, e këtë gjë e vërteton me veprimtarinë e saj, e cila në mënyrë indirekte mori pjesë në përgatitjen e luftës që u zhvillua në Gjakovë, midis forcave të Lidhjes dhe të ushtrisë osmane.

Si duket Mehmet Ali Pasha u mundua që të përfitojë parinë e qytetit të Prishtinës, mirëpo ai nuk pati sukses pasi që Dega e Lidhjes në Prishtinë në krye me Zija Prishtinën, myftiun e Prishtinës, Zejnel Abedinin dhe Abdurrahman Beun, të atin e Zija Prishtinës e refuzuan kategorikisht planin e tij për dorëzimin e Plavës dhe Gucisë, Malit të Zi dhe ndërmoi të gjitha masat për t'iu kundërvënë veprimeve të Mehmet Ali Pashës, lidhur me zbatimin e vendimeve të Kongresit, përkatësisht dorëzimin e tokave shqiptare shteteve monarkiste ballkanike.

Kjo Degë menjëherë e lajmëroi Këshillin Qendror dhe Degën e Lidhjes në Prizren lidhur me misionin e Mehmet Ali Pashës, duke kërkuar prej tyre që të mobilizoheshin për t'iu kundërshtuar propozimet e lartpërmendura lidhur me dorëzimin e disa territoreve Malit të Zi dhe Serbisë. Mehmet Ali Pasha, së pari, erdhi në Prishtinë, ku ishte qendra e Vilajetit të Kosovës, duke menduar se do ta bindte parinë e këtij qyteti si edhe anëtarët e Degës së Lidhjes në Prishtinë, mirëpo përpjekjet e tij nuk patën sukses. Posa arriti në Prizren iu vra telegrafisti i tij nga aktivistët e Lidhjes së Prizrenit, e ky ishte sinjali i parë që e bënte me dije Mehmet Ali Pashën se duhej të hiqte dorë nga misioni i tij. Pasi e mori vesh se këtë vrasje e kishin bërë aktivistët e Lidhjes së Prizrenit, ai menjëherë urdhëroi dhe kërkoi forca të mëdha nga Prishtina.

Në këtë kohë Dega e Lidhjes në Prishtinë ishte përforcuar dhe ishte një ndër degët më aktive të Lidhjes së Prizrenit. Kjo Degë nuk

i lejonte valiut dhe komandantit të ushtrisë së Vilajetit të Kosovës që të veprojnë në mënyrë të pavarur lidhur me mobilizimin dhe transferimin e ushtrisë prej një vendi në tjetrin, pa u konsultuar edhe me udhëheqësit e kësaj Dege. Në këtë rast, si duket, Dega e Prishtinës ka lejuar që të nisen dy taborë ushtarësh të përbërë nga ushtarët shqiptarë, kinse për ta ndihmuar Mehmet Ali Pashën, mirëpo më parë kishin marrë udhëzimet nga kjo Degë që në asnjë mënyrë të mos i sulmojnë forcat e Lidhjes Shqiptare. Këtë gjë e dëshmojnë edhe dokumentet angleze se elementi më i fortë, si bartës i rezistencës kundër pushtetit osman në këtë kohë buronte nga Dega e Prishtinës dhe ajo e Prizrenit. Flitej se Zija Prishtina kishte pretendime që të bëhej princ i principatës së ardhshme shqiptare.

Sipas njoftimit që jepte, më 16 prill 1879, Legata serbe në Stamboll, qysh në muajin mars dolën kërkesat e para për krijimin e gjykatave popullore shqiptare të cilat ishin të pavarura nga pushteti qendror osman. Në prill lëvizja për gjyqet shqiptare mori kahen e lëvizjes për vetëqeverisjen e vendit. Në këtë lëvizje, thotë J. Haxhivasiljeviqi, shqiptarët e Kosovës vepronin sipas udhëzimeve të Komitetit të Stambollit. Madje në krye të lëvizjes autonomiste, shënon ai, u vu Zija Prishtina, njëri nga anëtarët e tij. Sipas disa të dhënave Zija Prishtina ishte kryetar i Degës së Lidhjes për Prishtinën.

Lëvizja autonomiste filloi në Prishtinë në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, pikërisht aty ku pushteti perandorak ishte, për shkak të garnizonit ushtarak osman, më i rreptë se kudo qoftë. Në dhjetëditëshin e parë të muajit maj, këtu u zhvillua një mbledhje në të cilën morën pjesë rreth 800 veta të ardhur nga viset e ndryshme të Sanxhakut të Prishtinës, ku merrte pjesë edhe kryetari i Komitetit Qendror të Lidhjes, Ymer Prizreni dhe Zija Prishtina dhe anëtarë të tjerë të Sanxhakut të Prishtinës. Mbledhja miratoi një peticion drejtuar Portës, i cili përmbante tri kërkesa: që qeveria osmane të mos bënte asnjë lëshim të territoreve shqiptare shteteve ballkanike; që të lejonte formimin e gjyqeve të pavarura shqiptare; që të largonte ushtritë osmane nga Kosova, sepse shqiptarët ishin në gjendje të mbroheshin

më mirë se asnjëherë më parë. Më 7 maj 1879, një delegacion prej 27 vetash, të kryesuar nga Zija Prishtina, ia paraqiti peticionin valiut të Kosovës. Kërkesat bënë menjëherë efekt në Portën e Lartë, pesë ditë më vonë, më 12 maj 1879, qeveria e Stambollit pranoi, nga frika e rritjes së mëtejshme të protestës, krijimin e gjyqeve shqiptare, por vuri dy kufizime: që ato të ngriheshin vetëm në Vilajetin e Kosovës duke përfshirë edhe Sanxhakun e Shkupit dhe që ato të vepronin krahas gjyqeve shtetërore turke, duke ua lënë në dorë qytetarëve që të zgjidhnin njërin prej tyre.

Brenda një kohe relativisht të shkurtër, u mor vesh se Vilajeti i Kosovës fitoi të drejtën që të kishte gjyqe shqiptare, lajm ky që mori dheun. Në Prizren, Gjakovë e në Pejë, u kërkuar që me krijimin e gjyqeve popullore shqiptare, të suprimoheshin gjyqet shtetërore turke. Pastaj lëvizja u shtri edhe jashtë Kosovës. Kërkohej që gjyqet popullore shqiptare të krijoheshin edhe në Vilajetin e Shkodrës dhe të Janinës.

Për pushtetin e Lidhjes, të cilën e ushtronte në viset e banuara me shqiptarë dhe ndikimin e saj, na flasin shumë telegrame në të cilat shihet se pushteti lokal osman nuk ishte në gjendje që të marrë masa ndëshkuese ose luftarake kundër organeve dhe forcave të Lidhjes.

Disa telegrame të cilat janë dërguar Kryeministrisë në Stamboll nga qendra e Vilajetit të Kosovës më 3 gusht 1880, dëshmojnë se Lidhja kishte bërë largimin nga detyra e të gjithë nëpunësve të zyrave gjyqësore të administratës osmane që ishin suprimuar. Në këto telegrame theksohej se Dega e Lidhjes për Prishtinën, ku ishte edhe qendra e Vilajetit, ia dorëzoi organeve të Vilajetit një shkresë me 20 vula në të cilën vihej në dukje se me Vendimin e Komitetit Qendror të Lidhjes së Prizrenit janë shkarkuar nga detyra e nëpunësit e rinj të gjykatave qendrore brenda Vilajetit. Prandaj, kërkesat që do të paraqiteshin nga populli do të bëheshin sipas procedurës së vjetër të gjykatave të sheriatit dhe sipas zakoneve të vjetra. Gjithashtu theksohej se nuk mund të merreshin shpenzime të paligjshme nga populli, por do të merrej si në të kaluarën një taksë e vogël.

Komiteti Qendror i Lidhjes së Prizrenit dhe organet e saj, pasi që e shpallën qeverinë e përkohshme shqiptare, morën masa që t'i pastrojnë viset e tyre nga garnizonet ekzistuese osmane. Për këtë qëllim Lidhja e caktoi Sylejman Vokshin që, si kryekomandant të ushtrisë vullnetare shqiptare, të fillojë aksionet e largimit të njëjësive ushtarake osmane së pari nga Sanxhaku i Shkupit. Për këtë ka të dhëna edhe në raportin e konsullit austro-hungarez Valdhart, dërguar më 13 janar 1881 Baronit Von Haymerle, këshilltarit intim perandorak, ministër i shtëpisë mbretërore për Punë të Jashtme të Austro-Hungarisë. Në këtë raport thuhet se më 4 janar 1881 Sylejman Vokshi, aktivist i dalluar i Lidhjes së Prizrenit, në krye të 600 ushtarëve-kalorësve, e ka pushtuar Shkupin. Sipas udhëzimeve që ka marrë, Sylejman Vokshi, nga organet e Lidhjes së pari ka qenë i ngarkuar të marshonte kundër Prishtinës, por meqë vali u Osman Pasha nuk i lejoi të hynin në Prishtinë, ai u drejtua kah Shkupi.

Në vazhdim të raportit të Valthartit thuhej se: “Pardje Sylejman Vokshi vendosmërisht u nis me ushtarët e vet, të cilëve iu bashkëngjitën edhe 200 vullnetarë, nga Sanxhaku i Shkupit, në drejtim të Prishtinës për ta pushtuar këtë qytet dhe për të vepruar aty sipas urdhrave dhe vendimeve të Lidhjes së Prizrenit”. Posa kishte dëgjuar këtë lajm, vali u Prishtinës Osman Pasha ishte shqetësuar shumë dhe menjëherë e thirri mysafirin e këtushëm që ishte nisur me tren për në Prishtinë. Lidhja e kishte ndaluar gjithashtu komandantin ushtarak të Prizrenit të dërgonte në Prishtinë 12 topa fushe dhe topa të çeliktë në prapavijë për mbrojtjen e saj nga forcat e Lidhjes.

Të dhëna të ngjashme gjejmë edhe në raportin e valiut të Kosovës dërguar Portës së Lartë, më 12 janar 1881, për luftën e Lëvizjes Shqiptare për autonomi dhe për masat që duhej ndërmarrë për sigurimin e hekurudhës dhe nëpunësve shtetëror. Ky raport është shqyrtuar në Këshillin e Ministrave, me të cilën u njoftua edhe Ministria e Luftës, e cila duhej që sa më parë të merrte masa sigurimi dhe të dërgonte forcat ushtarake në viset shqiptare. Në raportin e Valiut thuhej: “Nëse nuk bëhet ndalimi i këtij transportimi nëpër

viset shqiptare, atëherë nëpunësit e hekurudhës do të vriten dhe do të zhduken nga ana e Lidhjes. Gjithashtu edhe njoftimet e zëvendësit të valiut të Selanikut vërtetojnë se komisarit të hekurudhës në Selanik i ka arritur një telegram kërcënues nga Lidhja, që ai të mos lejojë transportimin e armëve për në Shkup dhe Mitrovicë”.

Me këto aksione Lidhja orvatej të pengonte dërgimin e ushtrisë osmane dhe të materialit luftarak për në viset shqiptare dhe në këtë mënyrë të pengonte Qeverinë osmane që të shpërndante forcat e Lidhjes dhe të përmbyste Qeverinë e Përkohshme Shqiptare.

Për ta nënshtuar qendrën e Vilajetit - Prishtinën, në të cilën ende kishte mjaft ushtarë osmanë, forcat e Lidhjes pas një qëndrimi në Shkup, u nisën në drejtim të Prishtinës. Për këtë ofron të dhëna edhe raporti i zëvendësvaiut, drejtorit të financave të Vilajetit të Kosovës Fevzi Efendiut i cili, më 17 janar 1881, e njoftonte Kryeministrinë për mësymjen e forcave të Lidhjes kundër Prishtinës.

Në këtë raport thuhej se bashkë me ato forca që u kthyen nga Shkupi edhe 10.000 luftëtarë të Lidhjes janë tubuar në një vend tri orë larg Prishtinës dhe kanë lajmëruar se do ta sulmojnë atë. Mirëpo, valiu ka vendosur që t’u bëjë rezistencë me 1.000 ushtarë dhe nuk do t’i lejojë ta marrin Prishtinën. Mirëpo, si duket, Dega e Lidhjes në Prishtinë u aktivizua me disa aktivistë të saj dhe ndërmoi masat e duhura që ta pengojë valiun, duke bërë për vete të gjithë popullsinë e qytetit në emër të të cilëve iu dërgua një telegram i hollësishëm Portës së Lartë me të cilën kërkohet ndërrimi i valiut. Dega e Lidhjes në Prishtinë e ftoi popullsinë e këtij qyteti që të ngrihet kundër valiut dhe ushtrisë osmane duke e rrethuar ndërtesën e Vilajetit nga të gjitha anët dhe e ndaloi daljen jashtë saj. Dega e Lidhjes në Prishtinë e kishte shkatërruar rrjetin telegrafik dhe lidhjen me Stambollin. Derisa në qytet mbretëronte një trazirë e madhe, nëpunësit e administratës osmane ishin rrethuar në ndërtesën e Vilajetit nga popullsia. Ata nuk kishin mundësi të ndërmerrnin kurrfarë masash. Nga ana tjetër, forcat e Lidhjes ishin duke marshuar, një orë larg, në drejtim të Prishtinës.

Sipas korrespondentit osman Tefik Efendiu i cili, më 17 janar 1881, përmes Selanikut, e lajmëron Kryeministrinë për këto ngjarje, kuptohet se gjendja në Prishtinë ishte tejet e acaruar. Ishte duke u bërë përpjekja që valiu të pajtohet me popullsinë dhe ata të lejojnë lirim të tij nga ndërtesa e rrethuar, kurse në anën tjetër të gjithë nëpunësit kishin kaluar në anën e shqiptarëve për të mos ndodhur ndonjë gjakderdhje e madhe. Në vazhdim, Tefik Efendiu, informonte se forcat e Lidhjes do të hyjnë në qytet dhe nuk do të zbrapsen fare, kurse sonte ato janë stacionuar gjysmë ore larg qytetit. Në vijim të këtij raporti thuhej se nesër, më 18 janar 1881, në orën pesë, në qytet do të hyjnë 1.000 kalorës shqiptarë, e forcat e tjera do të arrijnë më vonë. Për vendosjen e forcave të Lidhjes nga popullsia janë përgatitur dhe janë vënë në dispozicion 280 shtëpi dhe janë caktuar për çdo shtëpi nga pesë persona dhe pesë kuaj. Të nesërmen Tefik Efendiu me telegram përsëri e lajmëroi Kryeministrinë se forcat që do të sulmonin Prishtinën janë afër 10.000 veta, kurse edhe 1.000 janë duke ardhur nga vise e tjera për të realizuar besën e dhënë, lidhur me çlirimin e Prishtinës. Këto forca ishin nga të gjitha viset e banuara me shqiptarë: nga Gjakova, nga Peja, nga Prizreni, nga Shkupi, nga Jeni Pazari, nga Sjenica, nga Tashlixha, nga Berana etj. kurse kryekomandanti i tyre ishte Sylejman Vokshi.

Nga bisedat telefonike të zhvilluara ndërmjet korrespondentit osman dhe Kryeministrisë së Stambollit shihet se forcat e Lidhjes e kishin lëshuar një proklamata me të cilën thirrej popullsia që t'ju bindej urdhrave të Lidhjes dhe askujt nuk do t'i ndodhte asgjë e keqe. Mirëpo, vendimin që e kishte marrë Lidhja për të çliruar Prishtinën, duhej zbatuar.

Përfundimisht sot, në mbrëmje, forcat e Lidhjes arritën në qytet, kurse paria e Prishtinës u doli përpara dhe i priti mirë. Organet osmane u dorëzuan pa bërë rezistencë. Nuk ndodhi asnjë konflikt i armatosur. As shqetësime nuk pati. Forcat e Lidhjes u bashkuan me masat e gjera të popullsisë së Prishtinës. Kurse qëllimi i ardhjes së forcave të Lidhjes në Prishtinë do të merret vesh nesër. Korrespondenti

osman e lajmëronte Portën e Lartë se në kryeqendër të Vilajetit të Kosovës ishte krijuar një atmosferë e përgjithshme shqetësuese pasi që ishte marrë qëndrimi që të ndërrohet vali, dhe se detyrën e tij kishte filluar ta ushtrojë shefi i financave, natyrisht sipas urdhrave të organeve të Lidhjes.

Forcat e Lidhjes, pasi që dje e morën Prishtinën thuhej në raport ishin duke pritur edhe forcat tjera nga viset e tjera. "Sikurse mund të merret vesh nga një vendim i miratuar posa të arrijnë edhe forcat e tjera, lajmëronte korrespondenti do të nisen për në Krujë (Akçe Hisar), dhe se atje do të mbajnë një kuvend të përgjithshëm popullor. Se çfarë do të bisedohet dhe çfarë vendimesh do të merren në atë kuvend, nuk kemi mundur të informohemi".

Pas çlirimit të Prishtinës forcat e Lidhjes vazhduan aksionet e tyre kundër garnizoneve osmane edhe në vendet e tjera. Më 22 janar 1881 e çliruan Mitrovicën, e më vonë Vushtrinë, Gjilanin e kështu me radhë edhe disa qendra kryesore të Vilajetit të Kosovës. Në këtë mënyrë pushteti i Qeverisë së Përkohshme Shqiptare plotësisht mbizotëroi në tërë Vilajetin e Kosovës. Qeveria e Përkohshme, me masat që ndërmori arrin të ventë rregull dhe qetësi jo vetëm në kryeqendrën e Vilajetit, por edhe në shumë fshatra, ku mbretëronte pasiguria. Rëndësi të posaçme Qeveria e Përkohshme Shqiptare dhe organet e saj i kushtuan edhe krijimit të marrëdhënieve të mira me popullsinë e krishterë të këtij Vilajeti. Veprimtarinë dhe aktivitetin e Qeverisë së Përkohshme e përkrahën edhe shtresat e ulëta popullore shqiptare dhe ato sllave.

Pas sukseseve që Lidhja arriti në Vilajetin e Kosovës, ajo zhvillonte një aktivitet intensiv duke u munduar që edhe në Vilajetin e Shkodrës dhe në viset e Shqipërisë Jugore të shkatërrohej pushteti lokal osman dhe t'i marrin në duar të veta degët e Lidhjes nëpër këto vise.

Qeveria e Përkohshme Shqiptare, siç del edhe nga bisedat telegrafike që i zhvilluan korrespondentët osman me Portën e Lartë, me rastin e marrjes së Prishtinës, bënte përgatitjet që të mbahej një

kuvend i përgjithshëm popullor në Krujë, ku do të shpallej edhe shteti i parë autonom shqiptar ose pavarësia e plotë.

Dega e Lidhjes në Prishtinë ishte njëra ndër degët më aktive krahas degëve të tjera në krye me Zija Prishtinën dhe Zejnel Abedin Prishtinën aktiviteti dhe veprimtaria e tyre e gjerë u ballafaqua me forcat e armatosura të Perandorisë Osmane, në njërën anë për të sendërtuar autonominë, e në anën tjetër u ballafaqua me forcat serbe për t'i mbrojtur kufijtë e Vilajetit të Kosovës që tentonin të depërtonin për t'i pushtuar edhe disa pjesë të Sanxhakut të Prishtinës.

Prof. dr. Iljaz REXHA

SUMMARY

THE ACTIVITY OF PRISHTINA BRANCH OF THE ALBANIAN LEAGUE OF PRIZREN

In this paper the author actively presents a historical description of Prishtina Branch of the Albanian League of Prizren. Prishtina Branch of the Albanian League was founded with the initiative of Abdurrahman Pashë Gjinolli, Zija Prishtina, Zejnel Abedin Prishtina and Ali Danish Prishtina, all of whom in the General Assembly meeting of the Prizren League, did not sign the written resolution of the meeting held on June 17, 1878 because they belonged to the so-called radical group represented by the wing of Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri, Ahmet Koronica, and Sylejman Vokshi.

The Gjinolli Family is widely known, as the founders of the town of Gjilan, which also have had governed the Province of Prishtina for over 100 years, including Vranjë, thus giving a very productive assistance in preparing the Albanian League branch settlement in this province. Zija Prishtina and his family members together with his father Abdurrahman Gjinolli created a special fund for financial aid in order to structure and settle down Albanian population which fled from the Nish province into Kosova Province because of the Serbian state and military persecutions.

